



**Profili i kompanisë:** LUFRA shpk. është kompania më e madhe e bulmetit në tregun shqiptar. Jemi krenarë të jemi zgjedhja e pare e konsumatorëve për produktet e bulmetit dhe vazhdimisht investojmë në përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe zhvillimin e talenteve brenda kompanisë.

**Pozicioni:** Specialist Marketingu (me fokus në Design & Marketingun Dixhital)

**Departmenti:** Marketing

**Vendodhja:** Tiranë

**Përshkrim i Pozicionit të Punës:** Specialisti i Marketingut në kompaninë Lufra asiston në planet marketing të kompanisë në përputhje me objektivat e kompanisë si dhe monitoron implementimin e tyre. Zhvillon kalendarin mujor të marketingut për realizimin e publikimeve në rrjetet sociale duke mbajtur fokus më të madh në anën grafike, design, krijimin e publikimeve në kanalet e marketingut dixhital dhe kryen një sërë detyrash me kërkesë të gjerë kreativiteti dhe objektiva të mirëpërcaktuar për të cilat kërkohen aftësi organizative dhe vullnet për të realizuar detyrat e përcaktuara. Raporton tek menaxheri i marketingut.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Krijon kalendarin e publikimeve në rrjetet sociale, filmon dhe editon foto dhe video për receta gatimi, të fermerëve, të stafit etj. sipas një kalendari të mirëpërcaktuar të cilat përdoren në kanalet e marketingut dixhital.
- Mbështet procesin e kërkimit të tregut, duke kryer vizita dhe pyetësorë në terren me konsumatorë dhe klientë të kompanisë apo duke koordinuar personat për fokus-groupe të realizuara nga departamenti i marketingut.
- Menaxhon dhe realizon shpërndarjen e materialeve marketing sipas planit marketing,
- Ndjek mbarëvajtjen e aktiviteteve të organizuara nga kompania,
- Ndjek me detaje planin e aprovuar të marketingut,
- Monitoron website dhe online marketing, krijon artikuj blog për në website,
- Monitoron trasmetimin e spoteve televizive dhe përmendjeve të kompanisë në media
- Mban kontakte të vazhdueshme me agjencitë e printimit për artikuj promocionalë
- Ndhmon në koordinimin për realizime të brandimeve, printimeve, implementimit të aktiviteteve marketing
- Krijon raporte për mbarevajtjen e rrjeteve sociale, jep ide për përmirësimin e tyre
- Editon ndryshime grafike në etiketa, banera kur është e nevojshme
- Mban dokumentacionin e detajuar për çdo veprim financiar në përputhje me aktivitetet e marketingut që ndjek,
- Monitoron aktivitetin e konkurrencës.

**Kërkesat e pozicionit:**

**a. Edukimi:**

- Diplomë universitare në profilin Marketing, Administrim-Biznes, Ekonomiks ose Graphic Design
- Trajnimet në fushën e fotografisë dhe graphic design përbëjnë avantazh

**b. Eksperiencat e punës:** Jo më pak se 2 vjecare në fushën e marketingut/graphic design

- Eksperiencat në agjensi marketingu përbëjnë avantazh

**c. Kualifikime të tjera:**

- Të zotërojë mire përdorimin e aparatit fotografik dhe të ketë aftësi të mira në design dhe editim fotosh/videosh
- Trajnime të ndryshme në lidhje me marketingun
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze (në të folur dhe të shkruar)

**d. Aftësi të tjera:**

- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit dhe të bashkëpunimit në grup,
- Të ketë qasje estetike në krijimin e përmbajtjeve për rrjetet sociale,
- Të ketë aftësi shumë të mira organizative,
- Të jetë person energjik dhe me vetëmotivim të lartë në punë,
- Të ketë iniciative për ide /risi në fushën marketing,
- Të ketë aftësi shumë të mira ndërpersonale.

**Mënyra e aplikimit:**

Për të aplikuar në këtë pozicion vakant jeni të lutur të dërgoni CV tuaj dhe letrën e interesit në adresën email: info@lufra.al deri në **dt. 31.12.2021**

Ju lutem vini re se do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*